



Siguria në internetbankën

Që të ndjehesh i sigurt kur t'i kryesh çështjet bankare në internet bankën, ne përdorim zgjidhje të provuara sigurie. Për të garantuar se je pikërisht ti i cili hyn në internet bankën, ke mundësi të përdorësh një metodë personale identifikimi, për shembull, identifikim bankar mobil (sued. Mobilt BankID) ose kutizën e sigurisë.

Jemi ne si bankë dhe ti si klient, të cilët së bashku, mund t'i mënjanojmë mashtrimet në internet.

Metodat identifikuese që ti përdor në internet bankën, konsiderohen si dokument identifikimi. Ti gjithmonë duhet t'i ruash kodet dhe fjalëkalimet dhe absolutisht mos t'ia tregosh dikujt ato, as bankës.

Këtë mund të bësh, për të zvogëluar rreziqet e mashtrimit në internet

- Përfundoje çdo vizitë në internet bankën, duke dalë jashtë nga faqja e bankës (fshij të dhënat hyrëse)
- Përditëso rregullisht shfletuesin e uebit, softuerin java dhe sistemin tënd operativ
- Përdor një program kundërvirus dhe mur zjarrdurues të përditësuar
- Ndrysho fjalëkalimin tënd në "routerin shtëpiak", që të mos jetë fjalëkalimi standard i prodhuesit.

Këtë mund të bësh për të zvogëluar rreziqet me kutizën e sigurisë

- Sigurohu gjithmonë që numri kontrollues të cilin e shtyp në kutizën e sigurisë
 - të fillojë me një 9-të, kur ti hyn në internet bankën me ndihmën e numrit kontrollues dhe kodit përgjegjës. Kur të hysh me kod të një hershëm, nuk dëfton ndonjë numër kontrollues.
 - është bazuar në numrin e llogarisë ose xhirollogarinë bankare/postare (shkurt suedisht: bg/pg) që ti e plotëson, kur ti e regjistron një marrës të ri.
 - të fillojë me një 0, kur ti do të miratosh një shumë, gjatë të bartjes (transferimit) ose gjatë pagimit (nëse shuma nuk është njëqindmijë apo më shumë).

Mbaj mend se banka asnjëherë nuk të dërgon ty si klient postë elektronike me kërkesat që ti t'i japësh të dhënat e llogarisë suaj, kodet, të përditësosh ose të shkarkosh programe, përmes një linku/vegëze njoftuar përmes postës elektronike. Nëse nuk je i sigurt, mos i hap letrat apo skadat e bashkëngjitura, të cilat i merr përmes postës elektronike.

Më shumë informata mbi sigurinë

Lexo më shumë mbi përgjegjësinë e bankës dhe përgjegjësinë tënde në swedbank.se/sakerhet ose telefonoj shërbimit të klientëve të internet bankës, në numrin e telefonit 0771-97 75 12.

Nëse ke pyetje lidhur me programin tënd kundërvirus ose murin tënd zjarrdurues, të lutem kontakto furnizuesin tënd.

